



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201801356/8

Tiranë ____/____/2018

Lënda: Rekomandohet fillimi i procedurës për të propozuar në Këshillin e Ministrave miratimin e dëmshpërblimit që i takon shtetasit M. C. si pasojë e përlogaritjes së gabuar të masës së zbritshme nga Enti Kombëtarë i Banesave

Drejtuar: Ministrisë së Drejtësisë
Sekretarit të Përgjithshëm në Detyrë
Z. Aurel LAMÇE

TIRANË

I nderuar Z. Lamçe,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi M.C., ish i dënuar politik, i cili pretendon se Komisioni i Rivlerësimit të Dëmshpërblimit në Ministrinë e Drejtësisë nuk ka marrë parasysh vendimin e gjykatës që ka llogaritur në një vlerë më të ulët apartamentin e përfituar si ish i dënuar politik i pastrehë, vlerë që ndikon në masën e dëmshpërblimit. Sipas ankuesit, ai ka përfituar një apartament, shuma e të cilit është zbritur nga dëmshpërblimi në të holla që ai përfitonte si ish i dënuar politik. Ankuesi duke pretenduar se vlera e apartamentit ishte llogaritur më e lartë se sa vlera reale i është drejtuar gjykatës me një kërkesë për llogaritjen e saktë të saj. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin Nr.200, datë 02.02.2016, vendim që ka marrë formë të prerë në Gjykatën e Apelit Vlorë. Shtetasi Mislli Celoaliaj i është drejtuar Komisionit të Rivlerësimit të Dëmshpërblimit me një kërkesë që të fillojë procedura për të përfituar dëmshpërblim në atë masë që i takon si pasojë e llogaritjes së gabuar të vlerës së apartamentit por, kjo kërkesë nuk është pranuar.

Për verifikimin e këtij rasti kemi patur fillimisht letërshkëmbim me Ministrinë e Drejtësisë. Në përgjigjen që kemi marrë me shkresën Nr.5155/4 Prot., datë 03.08.2018, ndër të tjera thuhet se: Ministria e Drejtësisë nuk ka qenë palë ndërgjygjëse në procesin civil dhe nuk rezulton detyrim për të në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ministria e Drejtësisë ka përmbushur detyrimin e vet ligjor dhe pretendimi për gabime të mundshme të kryera në përlogaritjen e dëmshpërblimit nuk ka ardhur si pasojë e veprimeve të kryera nga strukturat e këtij institucioni.

Referuar legjislacionit, Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës që shqyrton kërkesat e ish të dënuarve politik të regjimit komunist për të përfituar dëmshpërblim. Masa e dëmshpërblimit përcaktohet duke bashkërenduar punën me institucione të tjera. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Ministria e Drejtësisë i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e dëmshpërblimit, që shpërndahet nga Ministria e Financave (nenet 10, 11 dhe 13 të Ligjit Nr.9831, datë 12.11.2007 dhe VKM Nr.1253, datë 02.07.2008).

Gjykojmë se legjislacioni nuk e kufizon Ministrinë e Drejtësisë që të rivlerësojë masën e dëmshpërblimit nëse zbulohen prova shkresorë që nuk dihen gjatë zhvillimit të procedurës administrative ose provohet se janë bërë gabime në përlllogaritje. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin Nr.200, datë 02.02.2016, ka çmuar se përlllogaritja e vlerës së apartamentit që ka ndikuar në masën e dëmshpërblimit ka qenë e gabuar. Neni 451/a, paragrafi i parë, i Kodit të Procedurës Civile përcakton se, vendimet e gjykatës që kanë marrë formë të prerë janë të detyrueshme jo vetëm për palët, por edhe për institucionet e tjera¹. Një nga qëllimet kryesore që duhet të udhëheqë veprimtarinë e administratës publike është mbrojtja efektive e interesave të ligjshme të personave², që në këtë rast nuk është siguruar plotësisht. Pra, Ministria e Drejtësisë duhet të fillojë procedurën për dhënien e dëmshpërblimit ish të përndjekurti politik edhe në rastet kur konstatohen pasaktësi të informacioneve zyrtare të marra nga institucione të tjera, pasaktësi që kanë ndikuar në masën e dëmshpërblimit të përlllogaritur fillimisht. I tillë është rasti i shtetasit M. C., i cili ka arritur të provojë para gjykatës se vlera e apartamentit që është zbritur nga masa e dëmshpërblimit është më e ulët sa ajo që ka raportuar fillimisht Enti Kombëtarë i Banesave. Gabimi në përlllogaritjen e vlerës së apartamentin është konstatuar edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit që me shkresën Nr.74/4 Prot., datë 03.07.2015 ka vënë në dijeni Z. C. për përfundimin e hetimit të kryer për këtë rast. Kësaj shkrese i është referuar edhe Gjykata e Apelit Vlorë në pjesën arsyetuese të vendimit.

Bashkëlidhur rekomandimit do të gjeni fotokopje të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe të Gjykatës së Apelit Vlorë për rastin e shtetasit M.C.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Fillimin e procedurës për të propozuar në Këshillin e Ministrave miratimin e dëmshpërblimit që i takon shtetasit M.C. si pasojë e përlllogaritjes së gabuar të masës së zbritshme nga Enti Kombëtarë i Banesave.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, lutemi të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI

¹ Kodi i Procedurës Civile, Neni 451/a: *“Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera”*

² Kodi i Procedurës Administrative, neni 1: *“Ky Kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor.”*